



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.186/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve në shtylla të ndriçimit elektrik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa Anr.186/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit politik koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 02.10.2019, Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 01.10.2019, në qytet nga Komuna e tutje, monitoruesi i tyre ka hasur në poster të subjektit politik koalicionit AAK-PSD, të vendosura në shtylla të ndriçimit elektrik.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me nenin 33 pika b) e LZP-së, ligji nr. 03/L-073, si dhe Rregulla zgjedhore nr. 11/2019, dhe 13/2019. Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuara.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 pika b) të LZP-së, pasi posterët e subjektit politik koalicionit AAK-PSD, janë vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterëve.

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, dhe me Rregullat Zgjedhore 11/2013 dhe 13/2013, nga ana e subjektit politik koalicionit AAK-PSD, pasi që posterët në fjalë janë vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e posterëve, ashtu siç vërtetohet edhe nga fotografit e bashkangjitura, të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.186/2019 më datën 03.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.